



14/01/2021
02/03



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/_____

Datë: .14.01.2021

PROCESVERBAL

i mbledhjessë -VIII-(tetë) të rregulltë të Kuvendit Komunal të Malishevës

R E N D I D I T E S

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së VI-2020.
2. Shqyrtimi i Raportit nëntëmujor Financiar për vitin 2020.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-Rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e të drejtave të Fëmijëve.
4. Formimi i Komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/427 datë:16.11.2020 të parashtruar nga Shoqata Sindikale e Pavarur e Administratës në Malishevë.
6. Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë për Bujqësi rreth mbjelljeve vjeshtore (përsëritur)
7. Shqyrtimi i Raportit të DKAË-së, për përgatitjet dimërore nëpër shkolla (përsëritur)
8. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës nr.01/914 datë:15.09.2020, sipas kërkesës nr.01/137 datë:18.02.2020 të parashtruar nga anëtarët e kryesisë së fshatit Carrallukë, për caktimin e lokacionit dhe përkrahje financiare për ndërtimin e objektit të përbashkët me rastin e organizimit të pritjeve për raste të ndryshme (përsëritur).
9. Ndërtimi i Çerdhes së Re pa vendim të Kuvendit Komunal si dhe caktimi i lokacionit të ri për këtë Çerdhe (përsëritur).
10. Shqyrtimi dhe miratimi i Strategjisë për Komunikim si dhe Planit për Transparencë në Komunën e Malishevës 2020-2024.

11. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/287 datë:20.08.2020 të parashtruar nga Sylë Morina nga fshati Astrazup (përsëritur)
12. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/98 datë:25.11.2019 e parashtruar nga Hajdin dhe Ibrahim Shehu nga fshati Maxharrë, Komuna e Malishevës, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore (përsëritur)
13. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/381 datë: 08.10.2020 të parashtruar nga banoret e 4 familjeve Gegaj,Lagja Munishaj- Fshati i Ri (përsëritur)
14. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/1155 datë: 11.11.2020 të parashtruar nga Kryetari i Komunës, për dhënien në shfrytëzim të pronës publike KEDS-it, për vendosjen e re të stabilimenteve të nevojshme energjetike.
15. Emërimi i anëtareve nga AAK në Komitetet e përkohshme të formuara nga Kuvendi i Komunës.
16. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/256 datë: 17.07.2020 të parashtruar nga shefi i grupit të asambleistëve nga radhët e Nismës Socialdemokrate në Malishevë, lidhur me plotësimin e Komiteteve të përkohshme të formuara nga Kuvendi i Komunës (përsëritur).
17. Raporti i Drejtorisë për Urbanizëm, për realizimin e projekteve kapitale për vitin 2020.
18. Rishqyrtimi i vendimit nr.02/411 datë:03.11.2020, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e stadiumit ndihmës në Malishevë, sipas raportit të vlerësimit të MAPL-së nr.020-839/6 datë:17.11.2020.
19. Diskutimi dhe marrja e vendimit për lejin e mbajtjes së aktiviteteve sportive në Stadiumin “Liman Gagaj” dhe në fushat tjera publike, për të gjitha klubet dhe shkollat sportive.
20. Debat rreth pranimit të punëtorëve në kontratë mbi vepër në Komunën e Malishevës nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në bashkëpunim me Komunën.
21. Të ndryshme.

Mbledhja mbahet me datë: 30.11.2020 dhe filloi në ora 10:30 .Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: 19 asambleistë, drejtorë komunalë, zyra për informim.

Rrahim Morina: Korum kemi, prezent në mbledhje jemi 17 asambleistë.Vetëm tre anëtarë të Kuvendit kanë kërkuar leje, është Raimonda Krasniqi, Sylë Dukolli, Behie Sertolli, këta dy të fundit kanë antarët e familjes me Covid-19 dhe nuk mund të jenë pjesë e punimeve,për pjesen tjetër nuk kam kurrfar informacioni dhe vlerësoj se është nje papërgjegjësi e anëtarëve të Kuvendit.

Fillimishtë ju pershendes të gjithëve, antarë të Kuvendit, qeveri komunale dhe gjithë të pranishmit! Kryetari i Komunës Ragip Begaj ka qenë i infektuar nga ky virus dhe fatbardhësisht është shëruar, i urojm shërim të plotë dhe urojm që ti bashkangjitet dhe mbledhjes së Kuvendit dhe punës. Me datë 28 nëntor ka vdekur dhe mjeku i njohur dr.Ramë Morina, i cili ka humbur jeten nga ky virus, ka qenë një mjek bazament i mjeksies në Malishevë, ka kontribuar në avancimin, ngritjen dhe shërimin e pacienteve.Në shenjë respekti dhe në shenjë nderimi të punës së tij dhe gjithë të rënëve nga ky virus, kërkoj një minut heshtje. Nderim!

Të nderuar anëtarë të Kuvendit unë jam i mendimit që pika jashtë rendit të dites në këtë mbledhje mos të jetë, për shkak se kemi pika shumë dhe është një gjendje e jashtëzakonshme

pandemie, është një rrezikshmëri shumë e lartë, nëse do ishit pajtuar dhe ju. A po pajtohi? Mirë faleminderit.

Atëherë kalojmë për rendin e dites. Materialin e keni marrur, mirëpo janë dhe disa pika shtesë, që kanë kërkuar të futen në rend të dites dhe që vlerësohen si urgjenc. Unë do ti lexoj dhe pikat që duhet të hyjnë në rend të dites nëse votohen, nëse nuk votohen mbesin pa u futur. Është dhe një kërkesë e Sindikates së zjarrëfiksëve që sot e kemi shpërndar dhe ata kërkojnë që të jenë pjesë e kompenzimit për shujt. Ne e kemi pikën e rendit të dites për Sindikaten e Administratës dhe nëse ishi pajtuar që kjo pjesë ti bashkangjitet si material shtesë pikes së pestë, që të mos bëjmë pikë të veçantë. Ky është propozimi im.

Kush është për?

Për: 17

Kunder: 0

Apstenim: 0

Janë dhe dy kërkesa tjera që kanë kërkuar që të futen në këtë mbledhje në rend të dites, që do ti lexoj Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/425 datë: 26.11.2020, të parashtruar nga Komisioni Komunal i Aksionarëve lidhur me ndarjen e mjeteve për pagesën e anëtarëve të bordit të stacionit të autobusave në Malishevë. Kërkesa tjetër është shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02.454 me datë: 30.11.2020 e parashtruar nga Komisioni për menaxhimin e pandemis Covid-19 në Komunën e Malishevës. Hapi debat rreth rendit të dites. Avdi Morina e ka kërkuar fjalën.

Avdi Morina: Faleminderit Kryesues! Pershendetje drejtor, të nderuar kolegë, përfaqësues të shoqërisë civile dhe gjithë ju që jeni prezent! Unë mendoj që janë një numër i madh i pikave të cilat po barten prej mbledhjes në mbledhje, ndoshta kishte qenë më mirë që shefat e grupeve të diskutojnë ndonjë pikë që nuk është e domosdoshme të heket dhe të bartet në ndonjë mbledhje tjetër, sepse kemi ndonjë pikë e cila duhet të shqyrtohet më me prioritet. Komiteti për Politikë dhe Financa duhet të përgadit pikat e rendit të dites, mirëpo dhe atje ose po vin disa pika që janë më pak të rëndësishme dhe po ngelin disa pika të cilat mund të kenë një prioritet.

Klubi futbollit Malisheva ka bërë një kërkesë për Komitetin për Politikë dhe Financa për një mbështetje financiare. Unë kisha kërkuar që grupet politike që janë të përfaqësuara në këtë Kuvend, të vendosim një zëri që ta fusim në rend të dites kërkesën e klubit të futbollit Malisheva.

Rrahim Morina: Alban Mazreku e ka fjalën.

Alban Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Kryesues, ne e kemi marrur një rend të dites me 21 pika. Kërkesë e grupit tonë parlamentar është që pika numer 2. Shqyrtimi i Raportit nëntë mujor Financiar për vitin 2020, ne pothuajse hytum në muajin e 12, kisha kërkuar që kjo të hiqet dhe të shqyrtohet vetëm raporti 12 mujor i Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa. Propozimi nr.1 i joni është që ky me u hek ndersa propozimi numër dy është që pika 14 Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/1155 datë: 11.11.2020 të parashtruar nga Kryetari i Komunës, për dhënien në shfrytëzim të pronës publike KEDS-it, për vendosjen e re të stabilimenteve të nevojshme energjetike, është një kërkesë shumë e drejtë dhe shumë e qëlluar, për shkak të një furnizimi më cilësor me energji elektrike të gjithë këtyre banorëve, mirëpo në shqyrtim të materialit nuk po mundem me vërejt asgjë, për shkak të kopjimit të dobët që neve si asambleistë na ka ardhur. Kërkoj që kjo pikë të hiqet prej rendit të dites.

E kemi një kërkesë të klubit të futbollit Malisheva që ju ka drejtuar Kuvendit Komunal në Malishevë me datë: 26.10.2020, ku kërkon një mbështetje financiare në vlerë prej 118,000 euro. Ne si grup kërkojmë që të futete si pikë e dytë mbas shqyrtimit dhe miratimit të procesverbalit. Nga grupi jonë do ta ketë mbështetjen.Faleminderit!

Rrahim Morina: Alban Krasniqi e ka fjalën.

Alban Krasniqi:Pershendetje për të gjithë! Propozimi është që të mblidhemi shefat e grupeve 5 minuta dhe ti diskutojm pikat e rendit të dites dhe të dakordohemi, me qëllim që ti shmangemi debatit cilat me i heq e cilat me lanë, por duhet me kuptu që këtu jemi me i kryer detyrat tona. Po takohemi bashkarisht, e kam fjalën për këto që konsiderojm që kanë mbetur në rend të dites por që nuk janë dokumentet gati. Për sa i perket renditjes mundemi me u takuar dhe me e disku renditjen dhe me ardhur me propozime të përbashkëta, ose i themi kështu, nëse shkojmë kështu ka me na zgjatur më shumë debati.Për pjesën e ndihmës për klubin e futbollit Malisheva pajtohem, vetëm i kemi bërë disa kërkesa për dokumente.Nëse Drejtori i Kultures i ka sjellur ato dokumente sot e diskutojmë por mos të jetë pikë e dytë e rendit të dites .

Rrahim Morina: Faleminderit Alban! Sa i përket klubit të futbollit Malisheva, KPF-ja ka kërkuar disa sqarime. Ne drejtories ju kemi drejtuar me shkrim dhe kam biseduar me drejtorin Rexhep Mazreku dhe e luta që mundësisht të na përgjigjet në kërkesat tona që kanë qenë në pyetje dhe ta bëjnë një kërkesë shtesë që të hyjë në rend dite. Vetëm sa më arriti një material, drejtori Rexhep Mazreku ju ka drejtuar Kuvendit , ndërkohë mund ta bëjmë kopje. Valon e keni fjalën.

Valon Krasniqi:Pershendetje për të gjithë kolegët e asambles komunale,pershendetje Kryesues,drejtor! Në emer të grupit parlamentar të LDK-së, i shprehi ngushëllime familjes Morina për humbjen e doktorrit. Po nderlidhem te rendi dites, sa i përket kërkesave që na kanë ardhur këtu jashtë rendit të dites edhe grupi parlamentar i LDK-së është që ato kërkesa të futen në rend të dites. Unë po pajtohem me parafolsin, që shefat e grupeve parlamentare ta kenë një konsultim sa i përket rendit të dites.Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrahë kërkesen e klubit të Malisheves për ti ndihmuar klubit.

Rrahim Morina:Urdhëro profesoresh!

Hidajete Mazreku: Faleminderit Kryesues! Pershendetje kolegë asambleistë! Pasi që jemi tek renditja e numrit rëndor të seances që kemi për të mbajtur sot, grupi i grave asambleiste, në mbledhjen e radhes që kemi mbajtur, kemi dalur me disa rekomandime.

Unë do ti ceki këto rekomandime:

- 1.Në rekomandimin e parë i drejtohem Kryesuesit ta zbatojë më përpikmëri rregulloren e Kuvendit.
- 2.Të ndalohet fjalori ofendues ndaj secilit anëtarë të asambles dhe ndaj secilit anëtarë të subjektit.
- 3.Të rregullohen me ligj Komitetet obligative dhe jo obligative.
4. Kërkesat e qytetarëve që vijnë nëpërmjet zyres së Kryetarit, në rendin e dites janë gjithmonë ka fundi.Grupi i grave asambleiste ka marrur vendim që këto kërkesa ose të jenë në fillim ose ka mesi dhe të kenë hapsirë ata për rishqyrtimin e këtyre kërkesave. Faleminderit!

Rrahim Morina: Shefat e grupeve kanë 5 minuta pushim ,për konsultim të rendit të dites.

SHtyhen për mbledhjen tjetër këto pika të rendit të dites:Pika 2. Shqyrtimi i Raportit nëntëmujor Financiar për vitin 2020.Pika 6. Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë për Bujqësi rreth mbjelljeve vjeshtore. Pika 9. Ndërtimi i Çerdhes së Re pa vendim të Kuvendit Komunal si dhe caktimi i lokacionit të ri për këtë Çerdhe. Pika 17. Raporti i Drejtorisë për Urbanizëm, për realizimin e projekteve kapitale për vitin 2020.Këto janë 4 pikat që hiqen sot nga rendi i dites.

Tash do e lexoj renditjen s'i u dakorduar :

- 1.Procesverbali që nuk ndryshon fare.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/454 datë: 30.11.2020, të parashtruar nga komisioni për menaxhimin e pandemies Covid-19, në Komunën e Malisheves.
- 3.Mbështetja e klubit të futbollit Malisheva në Malishevë.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-Rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e të drejtave të Fëmijëve.
5. Formimi i Komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021.
6. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/427 datë:16.11.2020 të parashtruar nga Shoqata Sindikale e Pavarur e Administratës në Malishevë.
7. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës nr.01/914 datë:15.09.2020, sipas kërkesës nr.01/137 datë:18.02.2020 të parashtruar nga anëtarët e kryesisë së fshatit Carrallukë, për caktimin e lokacionit dhe përkrahje financiare për ndërtimin e objektit të përbashkët me rastin e organizimit të pritjeve për raste të ndryshme.
8. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/287 datë:20.08.2020 të parashtruar nga Sylë Morina nga fshati Astrazup (përsëritur)
9. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/98 datë:25.11.2019 e parashtruar nga Hajdin dhe Ibrahim Shehu nga fshati Maxharrë, Komuna e Malishevës, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore (përsëritur)
10. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/381 datë: 08.10.2020 të parashtruar nga banoret e 4 familjeve Gegaj,Lagja Munishaj- Fshati i Ri (përsëritur)
11. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/1155 datë: 11.11.2020 të parashtruar nga Kryetari i Komunës, për dhënien në shfrytëzim të pronës publike KEDS-it, për vendosjen e re të stabilimenteve të nevojshme energjetike.
- 12.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës 02/452 datë:26.11.2020 e parashtruar nga komisioni komunal i Aksionareve,lidhur me ndarjen e mjeteve për anëtarët e bordit të përkohshëm të stacionit të autobusave në Malishevë.
- 13.Rishqyrtimi i vendimit nr.02/411 datë:03.11.2020, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e stadiumit ndihmës në Malishevë, sipas raportit të vlerësimit të MAPL-së nr.020-839/6 datë:17.11.2020.
14. Diskutimi dhe marrja e vendimit për lejimin e mbajtjes së aktiviteteve sportive në Stadiumin “Liman Gagaj” dhe në fushat tjera publike, për të gjitha klubet dhe shkollat sportive.
- 15.Shqyrtimi dhe miratimi i Strategjisë për Komunikim si dhe Planit për Transparencë në Komunën e Malishevës 2020-2024.
16. Shqyrtimi i Raportit të DKAE-së, për përgatitjet dimërore nëpër shkolla .
17. Emërimi i anëtareve nga AAK në Komitetet e përkohshme të formuara nga Kuvendi i Komunës.

18.Shqyrtimi i kërkesës nr.02/256 datë: 17.07.2020 të parashtruar nga shefi i grupit të asamblistëve nga radhët e Nismës Socialdemokrate në Malishevë, lidhur me plotësimin e Komiteteve të përkohshme të formuara nga Kuvendi i Komunës .

19.Debat rreth pranimi të punëtorëve në kontratë mbi vepër në Komunën e Malishevës nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në bashkëpunim me Komunën.

20. Të ndryshme.

Kush është për këtë rend dite?

Për:21

Kundër: 0

Apstenim:0

21 asambleistë janë prezent dhe kanë votuar për rendin e dites .

Kalojmë te pika e parë e rendit të dites:Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së VI gjashtë -2020.

Për:20

Kundër: 0

Apstenim:0

Me 20 vota për aprovohet procesverbali i mbledhjes së VI-gjashtë për vitin 2020.

Kalojmë te pika e dytë:Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/454 datë: 30.11.2020, të parashtruar nga Komisioni për Menaxhimin e Pandemies Covid-19, në Komunën e Malisheves.Valon Krasniqi e ka fjalën.

Valon Krasniqi:Komisioni i pandemies Covid-19 në Komunën e Malisheves ka mbajtur 3 mbledhje të rregullta dhe ka shqyrtuar propozimet dhe kërkesat në lidhje me ndërmarrjen e masave nga institucionet lokale, për tju dalur në ndihmë qytetarëve, të cilat kapin vlerën prej 145.000 €. Faleminderit!

Rrahim Morina:Alban Krasniqi e ka fjalën.

Alban Krasniqi:Siq e përmendi parafolësi, ne kemi mbajtur tri mbledhje në të cilat i kemi diskutuar gjitha propozimet dhe kërkesat që kanë ardhur dhe më parë prej subjekteve të ndryshme politike, përfaqësuesve këtu në Kuvend dhe drejtorive përkatëse. Si shumë të përgjithshme kapin vlerën 145.000€. Natyra e veprimeve që ne mendojmë që duhet të ndërmerr në këtë rast ekzekutivi, fokusi është te rastet me asistenc sociale, te nënat vetë ushqyese, dhe familjet me asistenc sociale që kanë fëmijët nxënës që ndjekin procesin mësimor, por edhe tek studentet. Përmbytjen e rekomandimeve e keni të gjithë.

Vëmendje më të shtuar kemi tek stafi në sektorin e shëndetësisë, që është i nevojshëm për këtë fazë 6 mujore, gjithashtu vëmendje për mbështetje i kemi dhënë edhe rasteve të prekura me Covid, si një lloj ndihme në ofrimin e barnave falas, që atyre ju nevojitet për trajtimin nga Covid. Këto janë rekomandimet, nëse ka pyetje do ju përgjigjem unë ose kolegët tjerë të Komisionit. Faleminderit!

Rrahim Morina:Urdhëro, Halil!

Halil Morina: Të nderuar drejtor, kolegë asambleistë! Ne jemi munduar krahas mundësive tona si Komunë ti ndajmë disa mjete, të cilat shkojnë në favor të luftës ndaj pandemisë. Ne jemi munduar ti nxerrim disa rekomandime të cilat shkojnë në favor të ndihmës së qytetarëve sidomos atyre me asistencë sociale ose që nuk janë me asistencë sociale por që e kanë gjrëndjen ekonomike jo të mirë. Unë kisha kërkuar nga anëtarët e Kuvendit që të votohen këto rekomandime dhe të fillohen me u implement. Faleminderit!

Rrahim Morina: Valon e keni fjalën.

Valon Krasniqi: Ky Komision është krijuar si trup nga Kuvendi Komunal, nga të gjitha partit politike. Në këtë Komision kanë punuar anëtarë të partive politike dhe të gjithë kanë qenë të informuar që të jenë pjesmarres. Kërkoj që këto rekomandime të votohen dhe të ju dalim në ndihmë sa më shpejtë qytetarëve të Komunës së Malishevës.

Rrahim Morina: Kushtrim e keni fjalën.

Kushtrim Zogaj: Në emër të grupit të Partisë Demokratike të Kosovës, ne kërkojmë që të ketë një mbështetje financiare prej 50€ për rastet që rezultojnë më Covid-19, ndërsa për pensioneret mbështetja të jetë 100€.

Rrahim Morina: Hashim Vrenezi e ka fjalën.

Hashim Vrenezi: Pershendetje për të gjithë! Unë desha mu ndërlidhë te raporti i shpenzimeve që kemi bërë ndarjen e mjeteve për qështjen e Covid-it, raporti final nuk na ka ardhur akoma. Ne këtë ndarje e kemi bërë qysh në kohën e pandemisë dhe raport nuk kemi akoma. Mua më kish interesu dhe shuma totale e mjeteve që ka ardhur nga niveli qendror, për trajtimin e Covid-it të Komunës tone, sa është vlera e këtyre mjeteve dhe raporti i shpenzimeve të mjeteve që kanë ardhur nga niveli qendror, dhe këtë nuk e kemi.

Drejtori i shëndetësisë duhet me u zotë, që disa prej pikave këtu mundet me i përmbush, psh furnizimi dhe ndarja e medikamenteve të nevojshme për terapi, për rastet e infektuara me Covid, kush do ta kryej këtë procedurë? Si do të shpallet tenderimi?

Na duhen më shumë informacione që te kompletohet kërkesa. Faleminderit!

Rrahim Morina: Faleminderit Hashim! Alban Mazreku e ka fjalën.

Alban Mazreku: Kushtrimi e ceku që si rekomandim i 6 në kuader të këtyre rekomandimeve, që janë të bëra nga Komisioni te futet 50€ për gjithë ata që janë të infektuar me Covid-19 deri në moshën 65 vjeç, ndërsa prej moshës 65 vjeç që janë pensionista ta kenë të drejtën e një shume prej 100 €. Te rekomandimi i 5 e kemi bërë krijimi i një qendre të komunikimit dhe informimit në ambientet e ndërtesës së muzeut të qytetit, për ndihmë studentëve për shkak të ligjeratave online që kanë me i mbajtur, mirëpo muzeu hale rrymë nuk ka.

Rrahim Morina: Urdhëro profesoret!

Hidajete Mazreku: Faleminderit Kryesues! Unë desha me pyet në lidhje me raportin për Covid, kur janë ndarë mjetet nga Kuvendi, ne nuk e kemi marrur atë raport. Shtëpia shëndetit ka mungesë të puntorëve edhe të motrave medicinale dhe mjekëve, kanë marrë atë projektin që është dhe plus 7 puntorë kanë qenë të punësuar nga ato të holla që janë ndarë. A është bërë ai projekti apo është ndërprerë prokurimi? Në kohën e Covid-it kemi mungesë të mjekëve dhe motrave medicinale psh. Dializa ka punuar deri tash pa pagesa, puntorët të cilët kanë punuar janë shkuar nëpër shtëpi.

Rrahim Morina: Urdhëro Valon !

Valon Mazreku: Faleminderit Kryesues! Edhe ne si qeveri komunale kemi qenë pjesë përbërëse e këtij komisioni, i cili është miratuar në këtë Kuvend, ku propozimet kanë qenë të unifikuara dhe kanë qenë të komponuara në bazë të nevojave reale të Komunës tonë. Sa i përket raportit që e ceki asambleisti i PDK-së për ndarjet që i ka bërë Kuvendi Komunal diku rreth muajit mars ose prill 150.000€, raporti i kësaj nuk është pikë e rendit të dites. Ne mund ta sjellim raportin në një pikë tjetër, në rast se kërkohet. Sa i përket të hyrave nga qeveria, në bazë të pakos fiskale për Komunitet apo nivelin lokal janë ndarë 10.000.000€, ku këto i kanë karakterizuar në tri forma të mbështetjes. Komuna e Malisheves ka qenë përfitues nga kjo pako 217.500€, ndërsa drejtoria e arsimit është përkrahë nga një pako tjetër, që ka qenë e destinuar për Ministrinë e Arsimit, ku në kuadër të ministries ata i kanë shpërndarë nëpër Komuna varësisht prej numrit të nxënësve, është ndarë diku 250.000€.

Sa i përket prokurimit profesorësh i kemi ndarë në dy procedura, në dy aktivitete angazhimin e disa profesionistëve shëndetësor dhe transportin e emodializës. Edhe pak ditë është e hapur tenderimi për angazhim të profesionistëve shëndetësor, ndërsa është në fazën finale të nënshkrimit të kontratës të transportit për dializën.

Te pika e tretë Kushtrim që ju e propozuat një rekomandim tjetër, faktikisht ky rekomandim tipik që përfshihet te pika e tretë e rekomandimeve të komisionit të pandemis ku thotë Furnizimi dhe ndarja falas e medikamenteve të nevojshme për terapi për rastet e infektuara me COVID-19. Kjo ka qenë ideja që personat që janë të infektuar me Covid dhe të cilët janë në trajtim, ka raste të personat të cilët janë të infektuar ku kostoja e shërimit është më e madhe se 50€ dhe ka raste se është më e vogël se 50€ dhe ne e kemi ndarë një vlerë ku përfshihen gjitha këto raste.

Rrahim Morina: Urdhëro replikë Hashim.

Hashim Vrenezi: Ne kemi pasur kërkesa për raporte të tilla, mirëpo nuk na kanë ardhur asnjëherë. Është për qudë qysh mundeni me prit gjithë këta muaj, për me nda një fond prej 50.000€ për të trajtuar rastet me Covid. Komuna jonë i ka pasur rreth 40.000€ për trajtimin e Covid-it edhe në formë të ndihmave të pakove ushqimore edhe të medikamenteve medicinale, asnjëherë nuk na kanë prurë asnjë raport konkret, sa qytetar kanë përfituar prej subvencionit të pajisjeve medicinale.

Në fazën e pandemis QKMF-ja jonë është në tenderim, në fazën e rinovimit, shkatërrimit, demolimit, aty ka pasur raste që ska funksionu radiologu, rengeli ka punuar vetëm dy ditë në javë. Ka raste që nuk ka dezinfektant për dezinfektimin e shtretërve të pacientëve që marrin infuzionin aty. Ne jemi për me përkrah shëndetësinë, ne jemi për me përkrahë QKMF-në, qytetarët por njëkohësisht jemi për me i monitoru këto mjete për mos me u keqpërdorë.

Rrahim Morina: Urdhëro Alban!

Alban Krasniqi: Ata që e kanë votuar Komisionin për Menaxhimin e Pandemis Covid-19, në Komunitetin e Malishevës e dinë natyrën e punës së Komisionit dhe puna e Komisionit nuk merr fund me kaq. I kisha ftuar kolegët që ishin kritikë, këto kritika dhe propozime e kanë pasur vendin aty ku dhe këta janë të përfaqësuar dhe që kanë munguar.

Në aspektin e menaxhimit është konsideruar që është më e lehtë për ta dhe diskutimi ka qenë që ne me i gjetur format më të lehta të zbatimit me ju dalë në ndihmë, sidomos te medikamentet, nëse dojmë me targitu më lehtë problemin dhe me ju dalë në ndihmë qytetarëve sipas mundësive, është kjo pjesa që ne e kemi propozuar, e kemi ndarë një fond të caktuar, e merr listen e barnave esenciale për shërim, për trajtimin e Covid-it dhe përmes atij numri të medikamenteve që i ka, adresohet më lehtë qytetari në kuptimin e mbulimit të shpenzimeve, siq e tha dhe drejtori ka persona që e kanë Covid-in edhe pa simptoma ose me pak si simptoma sa

një grip dhe me 5 ero ose 7 ero askush nuk vjen me ti marr ato pare, pse ti ja kishe nda. E kemi diskutuar dhe kemi ardhur në një përfundim se kjo është forma më e mirë.
Sa i përket pjesës të qendres, propozimit nr.5 pëlqimi është marrur, tash është në fazën e tenderit ndërrimi i orëve dhe është qështje ditësh, 5 ditë është afati qysh kam marrur informacion prej prokurimit. Unë ju kisha kërkuar që ti përkrahni këto rekomandime.

Rrahim Morina: Urdhëro Avdi e ke fjalën!

Avdi Morina: Faleminderit Kryesues! Së pari desha të pershendës punën e Komisionit për Menaxhimin e Pandemies Covid-19 në Komunën e Malishevës. U diskutua ndarja e mjeteve buxhetore, që ke propozim i Hashim Vrenëzit që të ndahen nga 50€ për secilin person i cili është i prekur nga Covid-19, unë mendoj që pika 3 e mbulon shumë mirë mbështetjen e të gjithë atyre personave që janë të prekur me Covid-19. Shumë qytetarë e kalojnë pa probleme infeksionin me Covid-19 dhe disa për shkak të kushteve të mira ekonomike, nuk janë të interesuar fare që ta kenë një mbështetje të tillë. Kemi rastet që shumë pacientë që janë të prekur me Covid-19 kanë nevojë për një mbështetje më të madhe se 50 apo 100€ dhe unë mendoj që këta persona të mbështeten në bazë të mundësive financiare, në bazë të medikamenteve të cilat ja rekomandon terapien për shërimin e kësaj sëmundje.

Desha me ngrit një dilemë të pika 5 krijimi i qendres së komunikimit dhe informimit në ambientet e ndërtesës së muzeut, mendoj që për shkak të rrethanave qëfarë kemi dhe po kërkohet në një formë që të ruhet distanca, spo di sa hynë në përdorim dhe ligjeratat janë online dhe ndoshta e pengon njëri-tjetrin në mbajtjen e ligjeratave. Faleminderit!

Rrahim Morina: Alban Mazreku e ka fjalën.

Alban Mazreku: Kryesues dhe të nderuar asambleistë këtu ndoshta ka një keqkuptim, ne nuk e diskutim qështjen e punës ose mos punës së komisionit dhe as heqjen ose mos heqjen e pikes 3, ne kërkuam vetëm me ba një rekomandim shtesë, të infektuarit me Covid duhet me përdor terapien në kuader të pikes 3 me i furnizim shtepien e shëndetit me medikamente, mirëpo plus kësaj me ju lëshu dhe këtë 50€ si rekomandim i 6 për personat ner 65 vjeç ndërsa mbi 65 vjeç ka 100€. A është menduar te rastet e dyshuara me Covid, që ende nuk janë testuar por që kanë simptoma, që duhet me u përfshirë te pika e 3. Në kuader të këtyre rekomandimeve të futet dhe Raporti financiar që nuk është paraparë me këtë kërkesën e komisionit.

Nebih Bibaj: Të nderuar kabinet qeveritar, të nderuar kolegë asambleistë! Ideja jonë për ndarjen e 50 -100€ është për arsye se ata persona që e kanë kaluar Covid-in pika 3 nuk i mbulon. Pika 3 i mbulon vetëm ata që kanë me u infektuar me Covid, mirëpo qka do ju bëni atyre që e kanë kaluar Covid-19? Pika 3 dhe propozimi jonë është që edhe ajo pjesë të mbulohet. Kryesues mundësisht të hudhet në votim.

Rrahim Morina: Hashim jepe rekomandim të veçantë 7, jo në kuader të pikes e 3 sepse pika është e Komisionit dhe te pika Komisionit nuk mundesh me ndërhy.

Valon Mazreku: Ne thjesht e kemi rekomandu, është në doren e juaj me qu përpara ose mos me qu përpara. Rastet të cilat janë të dyshuara me Covid unë konsideroj se munden me dalë jashtë kontrollit dhe duke u mbështetur në mundësit tona si Komunë, nuk kemi mundësi ne me e mbulu këtë situatë. Logjika është që të mbështeten me terapi ata të cilët janë të infektuar aktiv, jo për periudhën për të cilën ka kalu, sepse mundësitë janë të kufizune. Unë konsideroj që pika e tretë i mbulon gjitha ato nevojat e domosdoshmëris aktuale të infektuarve me Covid, që me ju pagu terapia e tyre në bazë të mjekëve, pjesa tjetër nuk ka mundësi financiare të mbulohet. Këto pika janë ardhur si rezultat i gjitha grupeve parlamentare, të cilat kanë qenë pjesëmarrëse në këtë

komision dhe nga drejtoria e shëndetësisë. I keni raportet financiare sa herë që ka pasur kërkesë në drejtori të financave për raportim duke u bazuar në planin e punës të Kuvendit ku janë të pashqyrune periudhat e raportimit për secilen drejtori, i keni pasur raportet në faza tre mujore.

Rrahim Morina: Kërkesa e PDK-së është që ti shtohen dhe tri rekomandime Komisionit për Pandemi. Rekomandimi i 6 është të subvencionohen me nga 50 euro të gjithë të infektuarit deri në moshën 65 vjeç, mbi moshën 65 vjeç të subvencionohen me nga 100 euro të gjithë personat që janë të infektuar me Covid-19. E dyta të trajtohen edhe pacientet e dyshuar si të infektuar me Covid-19 dhe e treta është raporti financiar për pandeminë në Komunën e Malisheves.

Kush është për?

Për: 5

Kundër: 14

Apstenim: 3

Gjatë votimit për rekomandimet e Komisionit për Menaxhimin e Pandemisë, PDK lëshon sallen.

Kush është për rekomandimet e Komisionit për Menaxhimin e Pandemisë Covid-19?

Për: 16

Kundër: 0

Apstenim: 0

Shkojmë në pushim. Shihemi në ora 13:15.

Rrahim Morina: Vazhdojmë me piken e tretë Mbështetja e klubit të futbollit Malisheva. Drejtori e ka fjalën.

Rexhep Mazreku: Faleminderit Kryesues! Të nderuar asambleistë, kabinet qeveritar, kshilltar i Kryetarit, mjete të informimit dhe gjithë ju të pranishëm! Është një kërkesë e klubit të futbollit vs Malisheva, janë të precizuara kërkesat e tyre dhe mënyra se si shpenzohen mjetet, ne kërkojmë që të aprovohet kjo kërkesë. Nga Komiteti për Politikë dhe Financa kanë dalur disa pyetje dhe ne si drejtori e kemi për obligim që tu përgjigemi. Pyetja ka qenë a është i regjistruar klubi dhe si është i regjistruar? Klubi i futbollit është i regjistruar si shoqëri aksionare, e kemi dhe regjistrimin është i regjistruar me 20.08.2019, drejtor është Kastriot Kafexholli i mbështetur nga një kompani venodore e Malishevës. Ata kanë kërkuar një shumë të mjeteve, shpenzimet që i bëjnë brenda vitit ish diku 118.000 €, mirëpo ne kemi menduar që ti ndihmojmë me 50.000 € por nëse e shihni ju të arsyeshme mund ta rrisim shumën.

Pyetja tjetër është a është ndihmuar nga Komuna e Malisheves dhe përgjigjja është se po është ndihmuar, në vitin 2017 shuma është 15.830 €, në vitin 2018 me 20.950 €, viti 2019 me 23.500 €. Kërkoj nga gjitha grupet parlamentare që ta mbështesin klubin për arsye se përfaqëson qytetin. Faleminderit Kryesues!

Rrahim Morina: Shkojmë në deklaram në nivel të shëfave të grupeve. Fjalën e ka Avdi Morina.

Avdi Morina: Faleminderit Kryesues! Ajo që është me rëndësi, po shihet që egziston gadishmëria e grupeve politike që ta mbështesin klubin e futbollit Malisheva, i cili për nga formimi është shumë i ri mirëpo për nga rezultatet dhe sukseset po shihet që e meriton dhe në kuader të mundësive të tona si institucione ta ndihmojmë dhe ta përkrahim. Ne e kemi një kërkesë të klubit e cila ka vlerën 120.000€, e pash dhe një propozim që e tha Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport që të përkrahet me

50.000€. unë qysh në hartimin e projekt buxhetit që kemi pasur për këtë vit, kam kërkuar që sektorit të kultures, rinis dhe sportit ti ndahet një buxhet më i madh, sepse duhet me ju dhënë prioritet më të mëdha aktiviteteve të tilla, vlera prej 50.000 € mos rastesisht është sado pak modeste, mirëpo sdi sa kishte me i plotësuar nevojat dhe kërkesat që klubi jonë të tregoj suksese dhe rezultate.Me.ndoj që është mirë që ta mbështesim. Në emer të grupit parlamentar propozoj që vlera të jetë 80.000 € që të përkrahet grupi i futbollit Malisheva. Faleminderit!

Rrahim Morina:Urdhëro Nebih!

Nebih Bibaj:Faleminderit Kryesues! Ne si grup parlamentar duke e parë rendësin e madhe që e ka me i ndihmu futbollit në Malishevë, ne si grup parlamentar konsiderojm që mbështetja jonë do të jetë 100.000 € për këtë klub dhe 20.000 € për shkollat tjera private.Faleminderit!

Rrahim Morina:Nebih vetëm një çështje duhet ta kesh parasysh, ajo është pikë e veçantë për klubet, ne jemi duke folur vetëm për klubin e futbollit Malisheva në Malishevë.Urdhëro Valon!

Valon Krasniqi:Kërkesen e klubit të futbollit Fc Malisheva grupi parlamentar i LDK-së e përkrah, mirëpo un jam i mendimit që nëse ka vullnet edhe prej grupeve tjera që sa me shumë me nda mjete, aq më mirë ata do ta kenë performancën.Unë bëjë thirrje nga qdo donator apo biznese të cilat nuk janë dëmtuar nga pandemia, në formë vullnetar që tju dalim në ndihmë djelmoshave tonë dhe fv Malisheves.Faleminderit!

Rrahim Morina:Alban Krasniqi e ka fjalën.

Alban Krasniqi:Ne këtu jemi përfaqësues të qytetarëve dhe jo përfaqësues të një klubi.145.000€ kostoja e krejt qytetarëve të Komunës së Malisheves për me kalu Covid-in i ndajtum duke u munduar me ru këtë buxhet, e ju në emer të një shpenzimi të pa logjikshëm për mu permendeni shuma marramendse, un jam i bindur që klubi nuk është në gjendje me i menaxhu, mbi 50.000 € nuk më ban dora me qu përpijet dhe me dhanë mjete për një arsye shtesë sepse kemi njerz që nuk kanë dru te shpia tyre dhe ne nuk kemi pare me ju ndihmuar atyre njerëzve. Ne jemi klubin krenarin tonë sportive me përkrah dhe me e mbështet por duhet me i gjetë mekanizmat qysh me i përkrahë. Klubi është shoqëri me përgjegjësi të kufizume, është akoma biznes privat.I kemi 800 biznese në Komunën tonë dhe asnjë cent nuk ju kemi ndarë, ky klub aktualisht është biznes dhe unë jam me e trajtuar në mënyrë të veçantë dhe jam me i ndihmu, mirëpo ndihmën duhet me u mbikqyrë.Mbi 50.000€ nuk kemi mundësi me i nda.Është dhe një zgjidhje dhe unë jam për këtë zgjidhje që klubin ta merr në menaxhim Komuna e pastaj ka njëfarë kuptimi nëse ti po don me i nda 100.000 € sepse e merr në menaxhim Komuna, ose Komuna bashkëaksionare shumicen e aksioneve dhe bizneset një pjesë të aksioneve.Drejtori le të na tregon,nëse paska mjete, sa ka mjete dhe a ka mjete dhe bizneseve me ju pagu naser .Faleminderit!

Rrahim Morina:Urdhëro Luan!

Luan Kryeziu:Pershendetje për të gjithë! Edhe ne si grup i Aleances e përkrahum sa i përket mbështetjes të klubit futbollistik. Ajo pse ne si Malishevë mundemi me u krenu, është pikërisht ky klub që po na bënë mu ndi krenar.Ky klub duhet të jetë i pavarur ose të jetë nën menaxhimin e tij dhe mos të jetë i ndikuar nga ana e qeverisë komunale.Sa i përket pjesës tjetër që u kërku këtu, mundet me u ba një raport dhe me dergu në kuader të asambles, ku mundet me raportu vetë menaxheri i ati klubit për të arriturat, për shpenzimet dhe për gjitha ato që ndërlidhen me klubin. Nëse ne shkojmë ka pika që klubi mu menaxhu nga ana e qeverisë komunale, unë kisha me thënë se me këtë keq menaxhim që e ka Komuna e Malisheves , klubit do ti shkaktojë disfat dhe defekte në rrugëtimin sportive.Faleminderit!

Rrahim Morina:Drejtori na tregon mundësit buxhetore. Urdhëro!

Valon Mazreku:Pershendetje për të gjithë! Sa i përket kërkeses së klubit për mbështetje financiare në bashkëpunim me disa prej asambleistav kemi siguruar disa dokumente si janë përkrahë në kuader të superliges,fjala është për klubin e Flamurtarit dhe klubin e Prishtines, ta kemi parasysh klubet të cilat garojnë në arenat ndërkombëtare, patjetër duhet të mos jenë OJQ, për shkak se si të tilla këto nuk mundën me qenë pjesë e nje kompeticioni qysh janë garat ndërkombëtare, mirëpo janë si shoqëri aksionare dhe mbi këtë bazë Komuna e Prishtines ka nxjerrur një vendim ku i ka mbështetur klubet që janë të asaj Komune.

Ne si Komunë jemi të kufizuar në buxhet, mirëpo unë kisha preferuar që pavarësisht vendimit dhe vleres që do të ndahet për klubin, le të jetë për dy vitet fiskale, për këtë vit një pjesë dhe një pjesë për vitin e ardhshëm.Ajo qka ne jemi duke u angazhuar dhe kemi me ardhur shumë shpejt me një platformë ose me një pako se si do tu dalim në ndihmë dhe bizneseve të tjera të cilat nuk janë mbështetur nga Komuna për shkak të pandemies, së shpejti do ta sjellim një modalitet se si do ti mbështetum bizneset. Le të jetë Kuvendi i cili ta miratoj vleren për mbështetjen e këtyre bizneseve, sidomos bizneseve që kanë pasur dëme më të mëdhaja nga vendimet qeveritare për shkak të ndalimit të aktiviteteve të tyre.Për vitin e kemi një nivel më të lartë të subvensioneve, për vitin e ardhshëm i kemi 400.000€ të buxhetuara nga ky Kuvend në kategorin e subvensioneve. Pavarsisht prej vleres e cila do të ndahet, le të jetë vlerë e arsyeshme dhe që i kontribon edhe klubit, mirpo që nuk e dëmton buxhetin e Komunës.Faleminderit!

Rrahim Morina:Urdhëro Nebih!

Nebih Bibaj:Faleminderit drejtor! Duke mos e rënduar buxhetin për këtë vit prej 100.000 €, konsiderojmë këtë vit 50.000 € të jetë, 50.000 € vitin tjetër.Kryesues, ky është propozimi jonë.Faleminderit!

Rrahim Morina:Shkojmë në votim me propozimin e Drejtoris për Kulturë Rini dhe Sport vlera 50.000 €. Kush është për me ngritje të dorës?

Për:17

Kundër:0

Apstenim:5

Me 17 vota për aprovet kërkesa e Drejtoris për Kulturë,Rini dhe Sport për ndarjen e mjeteve prej 50.000€, për klubin e futbollit Malisheva në Malishevë.

Kalojmë në pikën e 4. Shqyrtimi dhe miratimi i draft-Rregullores për përkujdesjen dhe mbrojtjen e të drejtave të Fëmijëve. Kjo rregullore ka kaluar dhe dëgjimin publik, i ka kaluar gjitha proceduarat, unë e falenderoj komisionin që ka punuar dhe ka bërë një punë të mirë sidomos Vera ka qenë si udhëheqse e kësaj rregullore, nëse ishi pajtuar ishëm shku në votim.Kush është për aprovimin e rregullores?

Për: 20

Kundër: 0

Apstenim:0

Me 20 vota për aprovet rregullorja për përkujdesjen dhe mbrojtjen e të drejtave të Fëmijëve.

Kalojmë në pikën e pestë, formimi i Komisionit për Hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021. Gjithmonë e kemi planifikuar që shefat e grupeve janë pjesë e këti komisioni,Kryesuesi dhe një përfaqësues i Kryetarit.Shkojmë në votim me këtë formul.

Për: 20

Kundër:0

Apstenim: 0

Atëherë me 20 vota për është formuar Komisioni për Hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Malisheves.

Shkojmë te pika e 6. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/427 datë:16.11.2020 të parashtruar nga Shoqata Sindikale e Pavarur e Administratës në Malishevë, kësaj pike i bashkangjitet dhe kërkesa e Sindikates së pavarur të zjarrëfiksive njësia në Malishevë. Shkojmë në nivel të shefave të grupeve. Urdhëro Halil!

Halil Morina: Ne si Nism-ë e përkrahim dhe e mbështesim këtë lloj kërkesë të Sindikates, qoftë të Administratës së Pavarur qoftë të zjarrfiksive. Mua personalisht më duhen disa informacione shtesë, kur është nënshkruar kontrata kolektive me SBASHK-un në përgjegjësi, a ka qenë e parapane dhe për administratën shujta, qysh ka qenë e parapame për arsim. Në qoftëse ka qenë e parapame qysh atëherë për neve është në rregull më përkrah, në qoftëse dojmë me marr vendim sot atëherë nuk e di qysh mundemi me marr vendim për tri vitet e mëhershme, me një vendim të sotshëm. Mua më intereson me ditë ajo Sindikata kur ka bërë marrveshje me Qeverien për pagesën e shujtave, a kanë qenë të përfshim dhe puntorët e administratës edhe puntorët tjerë dhe në bazë të këtij informacioni ne mujm me dhanë. Ne në parim e mbështesim këtë iniciativë për arsye që të mos bëjmë padrejtësi sociale, meqë mësimdhënësit janë futur në këtë kontratë kolektive dhe disa prej tyre i kanë marrur mjetet e tyre me përmbarues. Faleminderit!

Rrahim Morina: Urdhëro Hashim!

Hashim Vrenezi: Faleminderit! Edhe ne si PDK jemi pro përkrahjes së kërkesës së shërbyesve civil, vetëm mos të bëjmë diferencime ndaj tyre, por ti trajtojmë të gjithë barabart, pavarësisht institucionin konkret ku janë duke punuar. Faleminderit!

Rrahim Morina: Në emër të LDK, Valon e keni fjalën.

Valon Krasniqi: Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah këtë kërkesë të Sindikates së Pavarur të shërbyesve civil dhe ne jemi idhtarë që mos të ketë diskriminime si të arsimit që dëgjova se disa kërkesa që janë bërë më vonë janë implementuar, ndërsa kërkesat që janë bërë më heret nuk janë implementuar, për shkak që ka pasur ndikime të drejtpërdrejta.

Rrahim Morina: Alban Krasniqi e ka fjalën.

Alban Krasniqi: Kryesues ky vendim e ka bazën e vet ligjore. Në bazë të ligjit të punës ku parashihet kontrata kolektive, për ti paraprirë zbatimit të kontratës kolektive, realisht Sindikatat bëjnë marrveshje me punëdhënësit e tyre. Në këtë rast unë e konsideroj si lloj marrveshje faktin e vendimit që ne e marrim, baza ligjore egziston, vendimi i Kuvendit është në një farë mënyre marrum tashmë përsipër ligjërisht e obligimeve që Komuna i ka sipas ligjit, por tash në formë vullnetare sipas kërkesës që e kanë bërë Sindikatat, i marrum në mënyrë vullnetarë obligimet për tju dal në zbatim të ligjit kategorive të caktuara, në këtë rast puntorëve të administratës dhe zjarrfiksive, sepse arsimtarët veq janë në kontratë të përfshirë me rastin e nënshkrimit që është bërë nga Ministria asaj kohe dhe kjo e ka hapur në një farë mënyre kutien e pandores, por dhe na obligon neve me kriju një farë barazie në mes punojësve, të cilët ligji i mbron njejtë. Puntorët e administratës secila Komunë i trajton veqantë, Komunitat marrin vendim për puntorët e

administrates.

Ne për zjarrfiksit e tanë do të marrim vendim, koston duhet me ditë, zbatimi i saj drejtor është mirë me na treguar si do të ndodh, sepse këtu është retroaktive përfshirë dhe vitin 2018-2019-2020, ka logjikë për mua sepse njëjtë janë duke u kompensuar dhe mësimdhënësit. Ne me përmbarues nuk kemi nevoj me shku, por duhet me shku përmes mënyrave që na jep ligji, e për këtë i kërkoj punëtorëve të administrates mirëkuptim që në rast se do të ketë vonesa në zbatimin e saj, mos le të na qojnë neve Kuvendit, pse ne po e marrum një vendim dhe po e marrum zotimin që me ju përgjigj juve, mos e merrni ju ndonje iniciativ tu u thirr në vendimin tonë me na qu në Gjykatë, se mas andej kjo nuk ka fare etik. Ne po zotohemi po e marrum për siper për me ju ofru një mbështetje financiare, e cila është e drejt e juaja e parapame me ligj, por qikjo e drejt për mu ba aktive atëherë është i nevojshëm një vendim, e këtë vendim po e marrum ne tash.

Kostoja aktuale është 189.000 euro veq për administraten, zjarrfiksat janë 29.000 euro, diku po i bjen 220.000 euro afersisht shuma që ne duhet tju paguajm. Kjo duhet tju paguhet faza faza ose me këste qysh do të dakordohet, ne mundem me marr dhe një vendim në këtë rast, nëse bashkë me drejtorin brenda këti vendimi me shiku qka mujna me ba që me pagua me këste këtë pjesë, që mos me i ngarku tash qeverisjen me do obligime që mas andej mujn me ka subjekt i gjykates, sepse dikush mundet me ngrit këtë çështje. Drejtori le të na jep naj sygjerrim te pranushëm me një qark kohor. Valon si kishim me i paguar më lehte 220.000 euro për gjatë periudhes kohore prej një viti, në sa periudha kishe mujt me i da për me i paguar, në mënyrë që brenda nje viti këta me i pas paret. Nesë i kemi dhe tani me i dhanë, trego e marrum vendimin që tani me ju dhanë. Faleminderit!

Rrahim Morina: Luan, urdhëro në emër të Aleances.

Luan Kryeziu: Ne si grup i Alences për Ardhmërin e Kosoves e mbështesim kërkesen e dalur nga ana e Sindikates së Pavarur e Administrates dhe njëkohësisht e shërbimeve të zjarrëfiksëve, mirëpo kisha me thënë njëjtë u cek dhe nga parafolësi që mos me prit vonesa që me na dalur në proces gjyqsor, qysh është tek kategoria e arsimit e cila është duke u ballafaquar me procesin gjyqësor dhe kuptohet që herët apo vonë ata do të dalin fitimtarë sa i përket kërkesës së tyre. Faleminderit!

Rrahim Morina: Të nderuar anëtarë të Kuvendit, kjo kërkesë është shumë e arsyeshme dhe shumë me vend dhe është e vonuar për mendim timin, për shkak se shëndetësia e merr, arsimit e merr, pse mos ti marrin dhe këta. Shuma është 2 euro për një shujt për vitin 2018-2019-2020 është kërkesa e administrates dhe kërkesa e zjarrëfiksave. Kush është për me ngritje të dores? Për: 20

Kundër: 0

Apstenim: 0

Konsideroj që është aprovuar kërkesa e administrates dhe e zjarrfiksave.

Kalojmë në pikën e 7. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës nr.01/914 datë: 15.09.2020, sipas kërkesës nr.01/137 datë: 18.02.2020 të parashtruar nga anëtarët e kryesisë së fshatit Carrallukë, për caktimin e lokacionit dhe përkrahje financiare për ndërtimin e objektit të përbashkët me rastin e organizimit të pritjeve për raste të ndryshme. Është vetëm ndarja e lokacionit, pa pjesën financiare.

Kush është për?

Për: 20

Kundër: 0

Apstenim:0

Me 20 vota për po ndahet lokacioni i kryesies së fshatit Carrallukë për ndërtimin e një objekti për organizimin e manifestimeve.

Kalojmë te pika 8. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/287 datë:20.08.2020 të parashtruar nga Sylë Morina nga fshati Astrazup. Të nderuar anëtarë të Kuvendit du me ju dhanë një sqarim ne kemi pasur të njëjtin rast, e kemi adresuar në Drejtorin për Gjeodezi dhe Kataster ka dalur në vendin e ngjarjes dhe na ka prurë një raport, sepse ky ka kërkuar me u kyq në rrugë, ka diku një hektarë që nuk është i kyqur fare por që rrethkohet me pronen publike. Prandaj është rasti i njëjtë që atëherë e kemi autorizuar Drejtorin për Gjeodezi ka dalur në teren dhe na ka prurë një raport dhe pastaj kemi votu, nëse mendoni në këtë formë shkojmë përsëri me autorizim drejtorin që të del dhe të na sjell një raport dhe kjo pikë kthehet dhe një herë në Kuvend dhe të votohet. Kush është për?

Për: 21

Kundër: 0

Apstenim:0

Me 21 voto për autorizohet drejtori për Gjeodezi dhe Kataster të del në vend të ngjarjes dhe të na sjell një raport.

Kalojmë te pika 9. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.06/98 datë:25.11.2019 e parashtruar nga Hajdin dhe Ibrahim Shehu nga fshati Maxharrë, Komuna e Malishevës, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. Vetëm një sqarim Kuvendi nuk ka marrur vendim për këtë, na e kemi quar në kshillim paraprak nga KPF-ja, mirëpo Ministria na ka kthyer kinse kemi marrur vendim. E kisha lutur Muharremin me na dhënë shpjegim rreth kësaj pike, pastaj hapim debat.

Muharrem Morina: Faleminderit Kryesues! Pershendetje anëtarë të asambles, drejtora. Kërkesa së pari ka ardhur te Kryetari për këtë ndërrim destinimi, është fjala një biznes në fshatin Maxharrë ka kërkuar ndërrim destinimi, bëhet fjalë për pronen e tij private, mirëpo ai duhet me u pajisur me leje ndërtimore dhe i duhet me ba ndërrim destinimi, ka ardhur në komitet nëse nuk gaboj sepse është lëndë e më hershme dhe është konsultuar Ministria e pushtetit lokal, ata thonë që ata e kanë konsultuar Ministrin e Planifikimit Hapsinor dhe pasi që ajo pjesë nuk është në hartë zonale dhe në PZHK si tokë ndërtimore, thotë nuk lejohet.

Ne hartat zonale ende nuk i kemi përfunduar, me të cilat mundemi me ba ndërrim destinimin e asaj prone, qytetari ka nisur me investu aty ka një biznes shumë të levërditshëm, ajo firma Shehu është. Është mirë me i dalur në krahë me i ndihmuar me dokumentacion. Drejtori i Urbanizmit nuk ka drejtë me i dhënë leje, për shkak se toka është tokë bujqësore. Është mirë me përkrah kërkesën e biznesit, e di që kemi me u ballafaquar prapë me Ministri, mirëpo biznesi duhet me e përkrahë, sepse është biznes i ardhur prej Gjermanie. Prej zyres Kryetarit nuk kemi mundur me i ndihmu dhe kemi kërkuar ndihmen e juaj. Prona është private është biznes privat, nëse ka mundësi Kuvendi me i dalur në ndihmë, me ja leju ndërrimin e destinimit dhe ai me marr leje ndërtimore dhe me vazhdu me procedura të mëtejme. Ne do të mundohemi ta arsyetojmë dhe ta fuqizojmë para Ministrisë së Mjedisit dhe për fajin tonë që nuk kemi arritur me i ba hartat zonale dhe me quajt atë zonë zonë ndërtimore, mos të pëson biznesi, mos të pësojnë qytetarët. Deri sa ne ti rregullojmë mos të pson një biznes i joni, një bashkëatdhetar që bënë një punë të vyer në fshatin Maxharrë.

Rrahim Morina:Kush është për:

Për: 22

Kundër: 0

Apstenim:1

Me 22 vota për aprohet kërkesa e Hajdin dhe Ibrahim Shehu për ndërrim destinim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Kalojmë te pika e 10. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/381 datë: 08.10.2020 të parashtruar nga banoret e 4 familjeve Gegaj,Lagja Munishaj- Fshati i Ri. Kjo është për një rrugë diku 200 metra. Nëse jeni për I kishum votu menjëherë dhe e kishum obligu Drejtorin e Urbanizmit që të merret me këtë çështje. Kush është për me shtrë këtë rrugë prej 200 metra në Fshatin e Ri?

Për:16

Kundër:0

Apstenim:8

Me 16 vota për, asnjë kundër dhe 8 apstenime aprohet kërkesa e këtyre 4 familjeve në Fshatin e Ri.

Kalojmë në pikën e 11.Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/1155 datë: 11.11.2020 të parashtruar nga Kryetari i Komunës, për dhënie në shfrytëzim të pronës publike KEDS-it, për vendosjen e re të stabilimenteve të nevojshme energjetike.Drejtorin e kemi këtu po kërkon një sqarim rreth kësaj çështje dhe shkojmë në votim.

Bashkim Krasniqi:Faleminderit Kryesues! Pershendetje për gjithë asambleistat,kolegë drejtor dhe gjithë ju të pranishëm. Ne kemi pranuar kërkesën nga Komiteti për Politik dhe Financa nr.02/448 të datës 25.11.2020, me anë të cilës është kërkuar informacion shtesë për lokacionet apo parcelat ku pretendohet vendosja e trafëve apo stabilimenteve, me anë të cilave konstatohet se gjitha këto prona janë prona publike, kryesisht janë rrugë, një praktikë që është duke e zbatuar kompania KEDS, të njëjtin rast e kemi pasur dhe në fshatin tonë ,aty ku e kanë paraparë vendosjen e trafëve është rruga me gjerësi 12-15 metra dhe që nuk është pengesë për vendosjen e trafos në njërin prej pjesës anësore dhe i njëjti rast është dhe të këto parcela që është kërkuar vendosja e trafostacioneve.

Kërkesa e KEDS-it është për 9 metra dhe saktësisht ne nuk e kemi bërë për trafo, ne nuk e kemi bërë ingjizimin gjeodezik, për shkak që ndonjëra prej tyre mundet me u ndryshu për pak metra, varsisht ata si e shohin të arsyeshme.Momentin që vendosen trafot ne dalim në teren dhe bëjmë ingjizimin konkret, saktësisht me kordinata ku është trafo dhe në bazë të saj mund të bëhet ndarja e parceles dhe me bërë kontratën për dhënie në shfrytëzimin me numër të sakt dhe me metër të sakt.Për kompenzim mundeni me vendos ju me vendim që e merrni.Si vendim mundeni me marrë tash, jepet në shfrytëzim për sa kohë dhe cili është qmimi apo kompenzimi që ata kanë më pagu, ndërsa precizimin e saj me kordinata me ndarjen e parcelave mundemi me ban ne mas andej, para se mu lidhë kontrata. Parcela nëse ndahet bahet për 0 , për 1 , për 2. Vendosja e trafëve është nëpër prona publike, kryesisht në ato vende ku ka hapsirë dhe nuk pengohet transporti dhe nuk paraqet pengesë për qytetarët.Për pagesa të pëlqimeve nuk është çështje e katastrofit.Faleminderit!

Rrahim Morina:Një sqarim, as nuk hynë në hipotek dhe as nuk jepet hipotek, as nuk mund të kalon te personi 3, jepet e vetme në shfrytëzim.Le të jetë për 50 vite.

Muharrem Morina:KEDS-i e ka bërë kërkesen te Kryetari, për me ja dhanë në shfrytëzim. Kërkesen Kryetari nuk ka kërkuar me ju dhanë atyre, por ka kërkuar me shqyrtu kërkesen e KEDS-it.E kam studju mirë kërkesen, e kam shikuar dhe ligjin për dhënjën në shfrytëzim, nuk kam parë që ka favore KEDS-i. Kam marrë ligjin për energjin, neni 9 organet e qeverisjes lokale duhet që në dokumentet e tyre zhvillimore duhet që të planifikojnë në mënyrën e furnizimit me energji, në ato dokumente ti harmonizojmë me strategjin kombëtare dhe paragrafi 2 përveq atyre që përcakton paragrafi 1, organet e qeverisjes lokale duhet në bashkepunojnë edhe me Ministrien, operatorin e sistemit të tranzicionit dhe operatorin e sistemit të shpërndarjes në lidhje me të drejtën në qasje në tokë ku duhet të vendosen pajisjet dhe stabilimentet energjetike. Me ligjin për energji atyre u lejohej me i shfrytëzuar pronat publike pa kompensim.Ju me vendim e caktoni kohëzgjatjen pa kompensim, pa të drejtë të transferimit të pronisë dhe mbi atë bazë lejen ndërtimore e jep Drejtoria e Urbanizmit, e kompletton dokumentacionin dhe shkon e vendos.Ne kemi të drejtë me ju qit tarifen, mirëpo në momentin kur e qesum tarifen ata i nalin investimet dhe kostoja e gjithë kësaj është se shërbimet janë ma të dobëta për qytetarët.Për dhënjën në shfrytëzim janë dy afate, afati shkurtë është 15 dhe afati më i gjatë është 15 deri 99 vite, ju përcaktoni.

Rrahim Morina: Shkojmë në votim, për 50 vite pa kompensim, nuk ka të drejtë ta fut në hipotek, nuk ka të drejtë ta ndërroj ndërrim destinimin.Kush është për?

Për: 22

Kundër: 0

Apstenim: 1

Autorizohet Kryetari që të bëjë marrveshje me KEDS-in.

E kemi piken e 12. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës 02/452 datë:26.11.2020 e parashtruar nga komisioni komunal i Aksionareve,lidhur me ndarjen e mjeteve për anëtarët e bordit të përkohshëm të stacionit të autobusave në Malishevë.Urdhëro Halil!

Halil Morina: E kam diskutuar sa herë që është ngritur puna e këti Komisionit të Aksionareve , e kam ngritur një shqetësim që ky Komision për neve si NISM-ë është i pa ligjshëm, i pa ligjshëm dhe në përbërje sepse i ka vetëm dy anëtarë e jo tre, i pa ligjshëm dhe me shkelje të procedurave të Kuvendit, andaj meqë Komisioni është i paligjshëm edhe derivacionet e ati Komisionit janë të paligjshme. Unë kam dhe dyshimet e mia me mënyrën se si është emru ai bord i drejtorëve,kshtu që ne si Nism Socialdemokrate nuk do ta votojm,por dhe në qoftëse votohet ky vendim unë kërkoj prej Drejtoris së Financave, që këto komisione të cilat janë të pa ligjshme, qoftë edhe komitetet të cilat janë ndërtuar duke mos respektuar rregulloren ose përbërjen e Kuvendit të mos marrin obligime financiare.Ne si Nismë Socialdemokrate votojmë kundër këti propozimi. Faleminderit Kryesues!

Rrahim Morina:Urdhëro Alban!

Alban Krasniqi:Kjo është thirrje destruktive dhe kësaj here mos e dëgjoni Halilin. 50.000€ i ndajtum për klubin sportive, e qe 1 vit janë duke punuar anëtarër e bordit dhe nëpër zyre të veta dhe shtëpi të veta duke bërë shkresa sepse njerëzit e caktuar e kanë bllokuar brenda stacionin dhe në të zezën janë duke i shpërndarë paret poshtë e neltë, e me këtë është duke u marrë policia. Me këtë që ti e the je duke i dalë përkrahë atyre dhe nesër ti ke me dalë keq dhe ke me dalë me kërku falje këtu.Thirrje më të ulët nuk kam dëgjuar në Kuvend, që as Komisionet as Komitetet ku janë këta mos me i pagu, veq që nuk ke qenë ti mos me i pagu.Unë i ftojë anëtarët e tjerë me votu, sepse është plotësisht e ligjshme dhe është në kuadër

të krejt asaj që e diskutuam deri më tani, njerëzit duke punuar pa anje pare, jemi duke folur për 200€ në muajt për dhjetra mbledhje e angazhime që i kanë mbajtur brenda viti. Është mirë me tërheqë atë që e the, sepse është jo etike.

Rrahim Morina: Shkojmë në votim për ndarjen e mjeteve për anëtarët e bordit të përkohshëm të stacionit të autobusave në Malishevë.

Kush është për?

Për: 15

Kundër: 0

Apstenim: 6

Me 15 vota për, asnjë kundër dhe 6 apstenime aprovohet kërkesa e Komisionit Komunal i Aksionareve, lidhur me ndarjen e mjeteve për anëtarët e bordit të përkohshëm të stacionit të autobusave në Malishevë.

Kalojmë në pikën e 13. Rishqyrtimi i vendimit nr.02/411 datë:03.11.2020, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e stadiumit ndihmës në Malishevë, sipas raportit të vlerësimit të MAPL-së nr.020-839/6 datë:17.11.2020. Është fjala për vendimin që e kemi marrur për stadiumin ndihmës, në rrethojen brenda që është përcaktu për stadiumin “Liman Gega”, kjo është kthyer për shkak se thotë nuk është në harmoni të plotë. E njëjta gjë është vetëm duhet të plotësohet nga Drejtoria e Urbanizmit dhe vazhdimisht ju themi që ta paraqesin në atë formën sepse nuk e kanë paraqitur këtë planin zhvillimor komunal, nuk e kanë përfshirë një nen dhe shkak i saj e kanë kthyer. A mujm ta votojmë që me plotsu atë nen dhe ta dërgojmë përsëri vendimin në MAPL.

Kush është për?

Për: 22

Kundër: 0

Apstenim: 0

Me 22 vota për aprovohet rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit Komunal për ndarjen e stadiumit ndihmës në Komunën e Malishevës.

Kalojmë në pikën e 14. Diskutimi dhe marrja e vendimit për lejimin e mbajtjes së aktiviteteve sportive në Stadiumin “Liman Gagaj” dhe në fushat tjera publike, për të gjitha klubet dhe shkollat sportive. Alban a dëshiron me marr fjalën?

Alban Krasniqi: Po besoj që dhe kolegët tjerë janë të njoftuar dhe kemi diskutu dhe me një pjesë dërmuese e këtyre që janë më të interesuar të çështjet sportive dhe këta vërejtjet prej klubeve të ndryshme, shkollave sportive. Ideja ka qenë që ta rregullojmë një orar të caktuar, na ka barrë neve, sepse në këtë rast konsideroj se drejtoria ka dështuar me krijë një orar të duhur për klubet, shkollat sportive dhe ka marrë vendim vetëm me i udhëheq të drejtën e ushtrimit. Në fushat tjera sportive deri në 100 nxënës i kam parë që ushtrojnë brenda një hapsire sportive, qka mujm me marrë në parim në vendim, kërkesa ka qenë që të diskutojmë bashkarisht, nëse mendoni ta bëjmë një komision me një afat të shkurt deri në mbledhjen e ardhshme me ardhë me zgjidhje të caktueme për këtë çështje, nëse mendoni me marrë një vendim të caktuar, ku themi që drejtoria me ardhur me një propozim konkret si e ndani orarin dhe sa e caktoni klubeve sportive dhe shkollave sportive me ushtruar pa e cenuar në këtë rast klubin e futbollit Malisheva. Klubi i futbollit Malisheva gjatë ditës i ka maksimum 2 orë që ushtron, pjesa tjetër është e dedikume për klubet tjera, por fatkësisht vendimi i drejtorisë ju ka ndaluar atyre, vetëm lojt kur luhen. Për shkak se kanë pritur me u marrë me rregullimin e orarit, e kanë marrë një vendim arbitrar me i ndalë. Unë mendoj që një herë në javë një shkollë sportive së paku mundet me i mbajt ushtrimet por jo më shumë, për një herë në javë mujm me gjetë kohë.

Rrahim Morina:Urdhëro Alban Mazreku!

Alban Mazreku:Kryesues, ndoshta si propozim kishte mundur me qenë që ne me obliguar Drejtorin për Rini dhe Sport, që së bashku me shkollat e futbollit ata le ta bëjnë orarin e vet, e ne sot vendimin e drejtorisë që e ka marrur për ndalim me anulë dhe drejtori në bashkëpunim me shkollat e futbollit le ta bëjnë orarin duke i dhënë hapsirë më tepër klubit të qytetit KF-Malisheva.

Rrahim Morina: Urdhëro Halil!

Halil Morina:Faleminderit Kryesues! E para kisha desht me qenë Drejtori i Kulturës këtu dhe me na sqaruar arsyet pse e kanë bërë këtë lloj ndërprerje, sepse ndoshta ka pasur arsye apo shkaqe objektive që e kanë detyru me marrë këtë vendim. Meqë drejtori nuk është këtu unë kisha propozu që kjo pikë me u shty për mbledhjen e ardhshme, ku Drejtori i Kulturës me i gjetë modalitet bashkë me klubet e futbollit, se si me e rihapë këtë vendim.Unë e dëgjova propozimin e Albanit që tha me anulë atë vendimin, mirëpo unë kisha thanë me lënë drejtorin me na treguar arsyen pse e ka anuluar. Ne me anulë kemi me anulë gjithsesi edhe në mbledhjen e ardhshme.Ne sot është mirë me obligu drejtorin në bashkëpunim me klubet me gjetë një modalitet qysh me hapë këtë punë dhe në mbledhjen e ardhshme me marrë vendimin.

Rrahim Morina:Urdhëro Alban Mazreku!

Alban Mazreku:Kryesues, drejtorja e ka marrë një vendim me 19.11.2020 nr. i protokollit është 12/170, mirëpo në këtë vendim nuk është asnjë arsye e cekne pse ju ka ndaluar shkollave të futbollit ushtrimi i veprimtaris në stadiumin e qytetit.Ne sot po e anulojmë këtë vendim, po e autorizojmë drejtorin e kulturës në bashkëpunim me shkollat e futbollit, le ta bëjnë atë orar dhe orarin le ta sjellin në asamble dhe ne mundemi me votu këtu në asamble.

Rrahim Morina: Po kërkohet me sjellë në Kuvend edhe orari. Urdhëro Avdi!

Avdi Morina:Faleminderit Kryesues! Unë pajtohem plotësisht që duhet të bëhet një orar i caktuar, ku jepet mundësia e shfrytëzimit të pakten nga një herë dhe e shkollave tjera.Drejtori i Arsmit është së bashku me ne në séance dhe ju e dini që shumica e shkollave kanë terene sportive dhe me ju dhanë mundësi klubeve në këtë rast shkollave private, në qoftëse nuk kanë mundësi ti ushtrojnë aktivitetet e tyre në stadiumin e qytetit, të mundën ti ushtrojnë aktivitetet në shkollat përkatëse, psh. kemi klubin e futbollit nga Drenovci ku mundën me ushtru aktivitetet e tyre në terenet sportive të shkollave, por njëkohësisht duke e pasur parasysh që duhet me u ru pasuria publike, me u ru sallat, me u ru fushat sportive që të mos dëmtohen, sepse këto shkolla në një farë mënyre kanë dhe të hyra financiare. Faleminderit!

Rrahim Morina: A po pajtohi që të votojmë në këtë form si e propozoj dhe Alban Mazreku dhe Alban Krasniqi, të autorizohet Drejtorja për Rini,Kulturë dhe Sport së bashku me shkollat e futbollit që ta bëjnë një orar dhe atë orar ta sjellin ta shohim ne dhe deri atëher vendimin me tërheq.

Kush është për ?

Për: 23

Kundër: 0
Apstenim:0

Kalojmë në piken e 15. Shqyrtimi dhe miratimi i Strategjisë për Komunikim si dhe Planit për Transparencë në Komunën e Malishevës 2020-2024. Kjo rregullore i ka kaluar të gjitha procedurat ligjore dhe ka ardhur në votim. Nebi Bibaj ka qen kryetar i këtij komisionit, urdhëro e keni fjalën.

Nebi Bibaj: Faleminderit Kryesues! Të nderuar anëtarë të Kuvendit strategjia për transparenc dhe plani i veprimit kanë qenë qysh në mujin mars, mbas rregullores për transparenc të cilën e kemi kaluar dhe në Kuvend, atëherë në atë kohë janë hekur si pika të rendit të ditës, për shkak se ne kemi pritur ligjshmërien prej MAPL-së për rregulloren për transparenc, pora të hypë në fuqi dhe rregullorja për transparenc të vijë në Kuvend dhe strategjia dhe plani i veprimit të votohet. Unë kisha kërkuar nga ju, zyra e informimit e ka bërë punën e vet dhe në bashkpunim me ne në rregulloren për transparenc të kalohen dy dokumente që janë shumë të rëndësishme për Komunën. Faleminderit!

Rrahim Morina: Hapim debat rreth kësaj pike. Alban Krasniqi e ka fjalën.

Alban Krasniqi: Kryesues, e para po uroj që ky plan i veprimit të zbatohet prej zyrës për informim, sepse deri tani ne kemi praktika ku një pjesë e punës së Komisioneve apo komiteteve nuk përcillet, për shkak se ka direktiva të caktuara, për mos me i përcjell ato. Ne edhe prej parafolësit për çështje të kalume që e patum, ishte një thirrje publike, mos me njoft një trup e cila është legjitime dhe kështu lloj thirrjesh dhe kështu lloj nxitjesh, edhe prej trupës qeverisëse këtu ka pasur presion dhe në drejtim të administratës për mos me i kryer punët e tyre, një mbledhje krejt e Komisionit të Aksionarëve është përcjellë, asnjë mbledhje tjetër nuk është përcjellë. Ne po e bëjmë një plan të veprimit, po shkruar që gjitha trupat kanë me u përcjellë dhe me u përfaqësuar puna e tyre në vërb faqe, por në praktikë nuk po ndodhë. Unë po uroj që kjo spaku të ndodhë dhe po i bëj thirrje administratës që të mos i nënshtrohet presionit të askujt, por le ta kryen detyrën ashtu siq është e parapamë me ligj, me ligjin për transparenc, me rregulloren që e kemi dhe me planin e veprimit tash që e kemi. Faleminderit!

Rrahim Morina: Kush është për miratim të Strategjisë për Komunikim si dhe Planit për Transparencë në Komunën e Malishevës, me ngritje të dorës.

Për: 18
Kundër: 0
Apstenim:0

Kalojmë te pika e 16. Shqyrtimi i Raportit të DKAË-së, për përgatitjet dimërore nëpër shkollë. Urdhëro drejtor e keni fjalën!

Blerim Thaqi: Faleminderit Kryesues! Pershendetje për juve asambleistë! Sipas planit të punës së asambles, drejtoria komunale e arsimit ka bërë raportin për vitin shkollor 2020-2021, i cili është dorëzuar në afatin e kërkuar. Fillimisht Drejtoria për Arsim dhe Drejtoria për Planifikim ka bashkëpunuar me shkollat, për ti identifikuar gjitha kërkesat e nevojshme për shkollat, që të bëhet përgaditja sa më e mirë për vitin shkollor 2020-2021, në kuadër të kësaj edhe përgaditjet dimërore. Ndërtimi i shkollave në këtë fazë janë në përfundim të ndërtimit të dy shkollave, në Gurbardh pothuajse është në përfundim, po ashtu në përfundim është dhe shkolla “Asim Vokshi” në Panorë, po ashtu dhe në Astrazup është ndërtuar salla sportive e shkolles “ Ganimete

Terbeshi” e cila është përruar ditë më parë. Janë bërë dhe disa intervenime që është kërkuar konform kërkesave të shkollave, në kuader të përgaditjeve për fillim vit dhe për sezonin dimëor të shkollave kemi pasur dhe renovime në riparime dhe mirëmbajtjen e shkollave në kuader të kësaj .Shumë renovime të shkollave janë kryer dhe disa janë dhe në proces të kryerjes së tyre, gjithashtu dhe te qështja e mirëmbajtjes dhe nyjeve sanitare.

Në kuader të infrastruktures dhe programeve për efqenc në kuader të vitit shkollor 2019, është kryer shkolla “Vesel Pagarusha” në Gurbardh, gjithashtu edhe shkolla “18 Prilli” në Burim, tani për tani kemi në këtë projekt edhe shkollën “Visar Krasniqi” në Drenovc, që pothuajse ne si Komunë po kompletohem në aspektin e nxemjeve duke përfshirë gjitha shkollat, në mungesë vetëm dy shkollave aktualisht që është “Visar Krasniqi” dhe “Labinot Krasniqi” në Mirushë dhe shpresojmë që vitin e ardhshëm do të pajisen dhe këto dy shkolla me nxemje.

Furnizimi me lëndë djegëse është bërë konformë kontrates së nënshkruar dhe sot të gjitha shkollat janë të pajisura me dru dhe me pelet, që e kemi shkollën “ Ramadan Morina” në Damanek.

Në këtë vit kemi pasur çështjen e përgaditjes së shkollave edhe në kuader të mbështetjes së master planit, i cili është aprovuar prej qeveries, me të cilën janë paraparë 3 komponente, që është mirëmbajtja e pajisjeve me material higjenik dhe paisjet më dezinfektues, ne si institucion qëndrjm mirë nëpër shkolla me paisjet e tyre me material higjenik ashtu dhe me dezinfekutes. Është e rendësishme të përmendet, kemi një kontrat të nënshkruar nga AQP-ja që bënë furnizimin me leter dhe material të ndryshum zyrtar furnizimi me toner, mirëpo kemi sfida në realizimin e kësaj kontrate, për shkak të neglizhences të operatorit që është përzgjedhur nga AQP-ja. Kemi dhe defekte momentale që kanë pasur në proces, siq është shkolla “Imer Krasniqi dhe shkolla “Nuhi Mazreku” në Guriq të cilët presim të bëjmë renovimin dhe sanimin e nxemjeve qendrore në këto shkolla dhe shumë shpejt realizohet dhe kjo pjesë e dëmtune. Faleminderit!

Nebi Bibaj:Faleminderit Kryesues! I nderuar drejtor faleminderit për raportin. Po ndalem te një konkurs i fundit që ka ndodhur në fshatin Gurbardh dhe Bellanic, kur një konkurrese aty ka qenë e përgaditur edhe me përvoj pune dhe është marrur një pa përvoj pune, po flas për një vajzë nga Kjeva ka konkuruar dhe në Gurbardh dhe në Bellanic nuk është marrur ajo por është marrur dikush tjetër pa përvoj pune, kjo e ka pervojen e punes dhe ka 240 kredi, nuk është mirë më vazhdu me këtë avazin e vjeter drejtor po mos ta ketë libezen e juaj nuk mund të jetë pjesë. Pse po i nxerrni punë vetit sepse ajo punë edhe në ankesa, në inspektoriat, është mirë një herë e mirë me u bërë e ditur që njeri që i plotëson kriteret për me qenë me një pozicion të punes merre, sepse i bënë nder dhe vetit dhe partis tënde dhe të gjithëve. Ju dhe në Gurbardh dhe në Bellanic keni marrur njerëz që e kanë kualifikimin më te ulët se ajo, në kriter është dhe përvoja e punes. Drejtor, te dritat në shkollën në Lladrovç flitet që kanë ardhur drita të përdorura, a duhet të jepet përgjithësi nëse është e vërtet kjo dhe pjesen tjetër fushen e volibollit në oborr të shkolles në Lladrovç ka mbetur sot e asaj dite pa u kryer, është mirë me i dhanë kahje asaj pune, cili ka qenë projektuesi dhe me shty atë punë përpara drejtor sepse është mbetur jashtëzakonisht keq.Faleminderit!

Alban Krasniqi: Raportin të cilin sot po e diskutojm ka kohë që e kemi pasur nëpër duar si anëtarë të Kuvendit dhe është diskutuar në KPF, mirëpo për shkak të shtyrjeve dhe mos arritjes së përfundimit të pikave të rendit të dites kjo ka mbërritur në fund të orarit zyrtar të punes së administrates dhe një pjesë e çështjeve tashmë ju ka humbur konteksti, një pjesë ka dhe çështje

tjera që janë shtua që janë në sferen e arsimit dhe është e nevojshme me i ditë dhe me i diskutu. Po i përmendi disa prej tyre; shqetësimi im vazhdon me mbetur në fushen e arsimit angazhimi i mësimitdhënësve, konkurset e shpallura, puna e komisioneve, paneleve intervistuese, gjitha këto që bëjnë me kuptim që kemi shkelje të një pas njëshme, kemi angazhim apo spërzgjedhje, proces të përzgjedhjes i bazuar tërësisht në disa faktorë subjektiv dhe jo objektiv sipas kritereve dhe standarteve. Vazhdoj me qenë i bindur, pa dëshirën time por me atë që ndodhë, është pothuajse e pamundur që një kuader i suksesshëm në Komunën e Malisheves i duhur arrin të punësohet në fushen e arsimit nëse nuk është pjesë e strukturave partiake të Nismes apo që nuk e ka dikan prej zyrtarëve të lartë të vetin aty dhe vazhdojnë me u diskriminu të gjithë ata ato të reja dhe të ri të cilët i plotësojnë tërësisht kushtet dhe kriteret dhe janë më të mirë se ata që përzgjedhen, pra nuk e kanë fatin, nuk e kanë mundësinë, diskriminohen prej paneleve intervistuese të cilët e kanë marrur një format të caktim të poetimit dhe të përzgjedhjes, i cili format është duke e dëmtuar arsimin në Komunën e Malisheves, sepse kuadrat e mira po kin ose po dalin jashtë ose shkojnë në Komunat tjera, ku arrin të punësohen në Komuna të ndryshme, por nuk arrijnë të punësohen në Komunën e Malisheves.

Tjetra ka të bëjë me mobilizimin e drejtoris dhe përgjigjjen e saj në raport me pandemin. Ajo qka kemi parë pas fillimit të vitit të ri shkollor, është se që në javën e parë të fillim vitit kemi parë një neglizhencë të drejtorëve përfshirë dhe personelin aty, në kuptimin e zbatimit të masave anticovid, kemi parë një papërgjithësi dhe të drejtorisë në menaxhimin dhe në kontrollimin e zbatimit të masave anticovid në institucionet shkollore të Komunës së Malisheves, dhe po ju them me përgjegjësi të plotë sepse këtu ka dhe kolege që janë mësimitdhënës dhe ata e dinë dhe më mirë se unë se sa zbatohen këto masa sot. Shkollat tona nuk i zbatojnë masat, duke filluar prej matësve të temperatures dhe është pranë publikisht që kjo nuk bëhet, sepse është e pa mundur me u menaxhu. Këtu ne duhet me diskutu mbi domosdoshmërinë e respektimit të udhëzimeve dhe domosdoja e respektimit të udhëzimeve nënkupton që nëse janë vetëm dy matës të bëhen 4 matës të temperatures, që secili mësimitdhënës të dal dhe ti kryej dhe këto detyra që i takojnë, sepse janë masa të përkohshme dhe të detyrueshme. Thirrja ime ndaj drejtorit dhe ndaj drejtorëve të shkollave dhe personelit arsimor është që të jenë në krye të detyrës, sidomos tek masat dhe respektimi i masave, që të bëjnë presionin e duhur personeli arsimor te ata drejtor të shkollave të cilët nuk ju ofrojnë kushtet e domosdoshme për punë, as mësimitdhënësve dhe as nxënësve dhe kushti elementar është matja e temperatures, pastaj dezenfektuesit përdorimi me rregullë, ujë, sapun, mjete higjienike për pastrim, distance brenda shkolles, gjitha këto janë elementare, pa hy në procesin e mësimitdhënies. Problem shtesë është se ata që kanë dyshime ose dalin pozitiv, si me u menaxhu ata tjerët që kanë pasur kontakt me ta, sa ne si Komunë i ofrojmë mundësinë e testeve qoftë në nivel qendror, apo në nivel lokal këtu me ja mbulu shpenzimin. Drejtor nuk na raportove sa masa administrative i ke marrur ndaj personelit, ndaj drejtorëve të shkollave në zbatim të detyrave të tyre në raport me masat anticovid, Unë po them se ka dhjetra shkolla që angazhimin e kanë 0.

E 3 ka të bëjë me strategjinë, qka nëse shkollat na mbyllen, drejtor hajde bashkarisht merre një kampanjë më të ashpër që të zbatohen masat dhe rekomandimet.

Sa prej shkollave ende nuk e kanë të rregullume nxemjen?

A ka pasur shkolla ku mësimit është mbajtur në kushte në të cilat nuk ka pasur nxemje?

A janë ndërmarr masat, a janë kryer këto punë që kanë të bëjnë me renovimin e kalldajave dhe cilat janë masat që kemi me i ndërmarrë nëse nuk janë ndërmarrë?

Faleminderit ?

Rrahim Morina:Sadija e ka fjalën.

Sadije Krasniqi: Faleminderit Kryesues! Pershendetje për të gjithë! Fillimisht si anëtare e Kuvendit dhe si anëtare e Komitetit për Barazi Gjinore në shenjë të solidarizimit të 16 ditëshit aktivizëm kundër dhunës në baza gjinore, kam vendosur simbole në shenjë të përkushtimit tim dhe përkrahjes sime të plotë ndaj eliminimit të qfardo lloj dhune ndaj qdo kujt, e veqanarisht ndaj dhunes ndaj grave dhe vajzave.

Drejtor, faleminderit për raportin unë kisha disa pyetje, pyetjen e parë e kisha rreth nxemjes në shkollën “Visar Krasniqi”, tash e disa vite shkolla nuk posedon nxemje qendrore, ne si Kuvend kemi ndar mjete dhe kemi marrë një vendim për atë nxemje, mirëpo ajo nxemje nuk është vendosur, mirëpo ka ardhur një fond tjetër dhe ajo nuk ka ndodhur, kështu që shkolla “ Visar Krasniqi” dhe këtë dimer është pa nxemje qendrore. Ju na thatë disa fjalë që ndoshta vitin tjetër, mirëpo kisha dashur që vitin tjetër mos të shkon më gjatë, sepse është bërë boll që ajo shkollë tash e sa vite është pa nxemje qendrore.

Pyetja tjetër drejtor është rreth furnizimit me dezinfektues dhe me material higjenik. Nuk tham që nuk ka dezinfektues dhe material higjenik, mirëpo jemi në një situatë që nuk është e mjaftueshme materiali higjenik, ka nevojë për më tepër material higjenik dhe dezinfektues, gjithashtu kisha dashur ta shtoni kontrollin dhe ta shtoni ndikimin e juaj ndaj drejtoreve, që me të vertet ka shkolla që masat anticovid nuk zbatohen në përpikëri, kështu që kisha kërkuar që këto masa në secilen shkollë të Komunës tonë të zbatohen në përpikmëri.

Pyetja tjetër është zëvendësimi i personelit arsimor që preken me covid, sa shkolla kemi të prekur, pra prej stafit arsimor, sa shkolla kanë mësimdhënës të prekur me Covid dhe si po bëhet zëvendësimi i këtyre mësimdhënësve?

Këto ishin pyetjet.Faleminderit!

Rrahim Morina:Faleminderit Sadije! Halil Morina e ka fjalën.

Halil Morina:Faleminderit Kryesues! Faleminderit drejtor i arsimit për raportin. Ne e dimë që sa herë të diskutohet për një çështje të caktuar të arsimit, shpeshher debati shpërndahet në të gjitha problematikat e arsimit. Ne e dimë që arsimi është një temë e gjanë, ku secili prej neve ka shqetësimet e ndryshme, kish qenë mirë me u përqendru vetëm tek raporti ku thotë raporti vjeshtor i përgaditjes së mësimi. Sa i përket respektimit të masave anticovid, ne e dimë dhe jemi të vetëdijshëm jo vetëm në shkolla, por në përgjithësi tek qytetarët nuk është duke u respektuar masat anticovid dhe për me luftu pandemien duhet që secili qytetar vetë me dhanë kontributin, sepse është e pa mujshme institucioni me i mbajtur nën kontroll krejt qytetarët. Masat duhet të respektohen prej nivelit më të lartë, e pastaj me ardhur deri te nivelet poshtë. Sa i përket respektimit të masave nëpër shkolla, unë po flas në Gjimnazin”Hamdi Berisha” ku unë punoj, sa i përket materialit shpenzues ka të mjaftueshëm, në secilen klasë është nga një dezinfektues, mirëpo masat tamen nuk respektohen qysh janë në leter, andaj drejtor duhet me ba më shumë përpjekje përmes drejtorisë së inspektoriatit me i inspektu këto shkolla, jo një drejtor me detyru mësimdhënësin me ardhë në shkollë edhe mbasi e ka bërë testin me ardhur në shkollë deri t’i del pozitiv, ajo është veper penale.Unë personalisht kam pasur disa simptoma dhe nuk kam shkuar në shkollë, e kam bërë testin dhe deri sa është dalur testi negative nuk kam shkuar në shkollë. Ne e kemi obligim që këto masa që i kemi me i respektu. Faleminderit!

Rrahim Morina:Urdhëro drejtor!

Blerim Thaqi: Faleminderit Kryesues! Nebi po pergjigjem tek ti së pari, është e vertet që kanë qenë dy konkurse , konkursi në shkollën “Isamajl Qemajli” me 12 orë dhe 8 orë në “ Afrim Krasniqi” një vend pune dhe një në Gurbardhë, sipas informacioneve që i kemi marrur dhe zyrtare atje kanë aplikuar 6-7 kandidat të kualifikuar që kanë plotësuar të gjitha kriteret, nuk ka shanc në konkurset në Malishevë të hynë në punë dikush që nuk i plotëson kriteret kur ka kritere dhe e drejta ankeses është e lejshme për të gjithë. Kanë ardhur ankesa do tu pergjigjemi, janë institucionet perkatese që japin pergjigje rreth kësaj. Pervoja e kandidatit në fjalë është 5 muaj, mirëpo në pjesen e vlersimit të komisionit hyne dhe kualifikimi, sepse është kerkuar dhe në konkurs, i përmbahen rregullave të konkursit, në qoftëse ka drejt pala inspektoriati i arsimit e vlerson e kthen, jam për zbatim të qfardo vendimi që binë inspektoriatet, mirëpo deri tani nuk kemi pasur asnjë kundërshtim të ndonjë vendimi të komisioneve që kemi pasur deri tash. Te çështja e dritave të shkollave në Lladrovë dhe fusha e shkolles, për këto dritat është çështje e mbikqyrës nuk e di së qka është vendosur.

Te puna e fushes kam bërë presion, kemi pergjigje jo zyrtare që operatori thotë se hale nuk ka pare dhe i ka ngadalsu punimet.

Njoftimet zyrtare publike në televizionin publik dhe pergjigja që ju është dhënë prej Ministries së Arsimit ka qene për krejt shkollat dhe ne nuk kemi nevoj me bërë dhe një herë njoftimin. Ne e kemi gripin e drejtoreve që i kam njoftuar që përms prindërve dhe mësimeve të njoftohen nxënësit, mbi 60% të shkollave në Komunën tonë kanë mbajtur mësim sipas njoftimeve që kam 11 shkolla skan mbajtur mësim. Kemi ardhur në një situatë që dikush prej një sindikate merr vendime dhe nuk të pyet hiq. Neve nuk na lejohet me marr masa ndaj mësimeve për këtë rast sepse është përgjegjes Sindikata, sepse jeni anëtarë të Sindikates dhe përgjegjës in e merr Sindikata. Te çështja e angazhimit të mësimeve, nuk ka mësime që angazhohet në punë i pa kualifikuar, kemi angazhime të brendshme. Po lidhem te çështja e angazhimit të rasteve të Covid-it, me sëmundje të rënda i kemi 7 mësime që me master plan kemi angazhuar 7 mësime shtesë, ndërsa për mësime që kan Covid-in në peridhen dy javore ose tri javore bëhet zëvendësimi nga kolegët e brendshëm sidomos prej klases së 6 deri në klasen e 12, kemi raste dhe prej klases së parë deri te e 5 por kemi me dy grupe punë që bëhet angazhimi i tyre dhe pagesa e tyre kryhet me buxhetin e ndarë nga master plani i aprovuar prej qeveris.

Shkollat janë të pajisura me dezinfektues me material higjienik, me nyje sanitare që janë rregulluar. Unë ndihna mirë që prej 12 marsit në shkollat tona që vijnë rreth 12.000 nxënës, vetëm dy nxënës kanë qenë të infektuar me Covid në periudhen dy javore dhe janë kthyer në mësim, është rasi në Damanek që është bërë testi për 178 personave duke përfshirë stafin edhe nxënësit dhe raporti prej 12 marsit i kemi 25 mësime aktiv, 23 janë të shëruar, 14 janë të izoluar për shkakun që familjarët kanë qenë të infektuar dhe 39 nxënës që kanë munguar në periudhen sa kanë qenë familjarët e tyre me Covid. Është falenderuese për institutin në Prizren i cili na ka dhënë mundësin që një ditë përpara me tregu për me shku me ba tesin dhe të nesrit i ftojnë dhe shkojnë qdo mësime që ka simptoma. Te çështja e zbatimit të rregullave ndoshta nuk është qind për qind, mbi bazen e komunikimit që kemi pasur me institutin dhe me Ministrinë e Arsimit është e pa mujshme të kontrollohen qoftë edhe me 15 pajisje të matjes së temperaturës 1000 nxënës, mirëpo është propozuar që ata që kanë simptoma nuk duhet të lejohen të hyjnë. Kemi pasur inspektime nga instituti Avoka nga inspektoriati sanitar në Prizren në 4-5 shkolla inspektim, vetëm një vërtetë e kemi marrur në gjimnaz dhe menjëherë kemi marrur masa. Çerdhja sot dy javë është e mbyllur, kanë dalur 5 punëtorë me Covid dhe e kemi mbyllur, s'i të kthehet pergjigja nga institute për këta puntorë ne do ta rikthejmë.

Te çështja e kalldajave Alban aktualisht i kemi dy shkolla pa nxemje shkolla në Guriq “Nuhi Mazreku” e cila ka telashe me pomp percjellëse dhe jemi munduar me sanu, mirëpo kërkohet të ndrrohet pompa dhe shkolla “Imer Krasniqi” që nxemje nuk ka mirëpo duke i falenderuar prindërit dhe motit që nuk ka qenë shumë i keq, ata kanë mbajtur mësim deri të premtën me nxemje që i kanë siguruar familjarët nëpër shkolla. Kemi nisur procedurat për këto dy shkolla dhe dy shkolla tjera që kanë defekte qoftë në radiator dhe nuk lejojnë percjelljen e nxemjes në koridore, ka shkolla që ka dy pompa dhe njëra nuk funksionon dhe për këtë arsye kemi bërë një kërkesë edhe te Kryetari dhe te Drejtori i Financave që të rregullohen këto dy qështje, telashen më të madhe e kemi në “Imer Krasniqi” që duhet të ndërrohet kalldaja dhe besoj deri në fund të javës do të rregullohet. Kalldaja në shkollën Imer Krasniqi ka qenë shumë mirë, mirëpo aty ka ndodhur një aksident, sipas informacioneve që kam para dy viteve është ndërruar e re. Në “Visar Krasniqi” për të mirën e buxhetit të Komunes kanë marrur për obligim Ministria e Zhillimit Ekonomik 3 shkolla Pgarushë, Burim dhe “Visar Krasniqi”, është punë e tyre, ne ju kemi lejuar në kuader të efijences kemi bërë kërkesën edhe për Mirushë me efijenc me pajisur dhe Mirushen.

Rrahim Morina: Ju kisha kerkuar Kryetarët e Komiteteve që ti sjellin raportet e punës që i kanë pasur gjatë vitit 2020. Kalojmë në piken tjetër Emërimi i anëtarëve nga AAK në Komitetet e përkohshme të formuar nga Kuvendi i Komunës. Luan a i keni emrat?

Luan Kryeziu: Komiteti për Planifikim Urban Kataster dhe Mjedis s'i emer e kemi propozuar Dibran Krasniqi.
Komiteti për Arsim -Mergim Kryeziu.
Komiteti për Diaspor- Egzon Javori.
Komiteti për bujqësi-Nebih Kryeziu.
Komiteti për Familje të Dëshmorëve, Invalidëve dhe Veteranëve të Luftes- Fanol Shala Komiteti për Shendetësi-Brendon Gajraku.

Rrahim Morina: Kush është për anëtarët që i propozoj Luani për përfaqësuesit nga AAK- ja me ju plotësuar Komiteteve. Kush është për?

Për: 13

Kundër: 0

Apstenim:6

Me 13 vota për asnjë kunder dhe 6 apstenime plotësohen Komitetet të përkohshme nga AAK-ja.

Kalojmë në piken tjetër:Plotësimi i anëtarëve të këtyre Komiteteve të përkohshme nga Nisma Socialdemokrate. Urdhëroni dikush nga Nisma!

Halil Morina:Faleminderit Kryesues! Ne qe dy-tri seanca në konform vendimit që është marrur në fillim të kësaj legjislature për me u themelu Komitetet qysh e thatë jo obligative, ashtu si i ka konsultuar Kuvendi dhe si ja keni lënë Nism-as nga dy vende, ne i kemi prur emrat, shefi i ka lexuar, Kryesues ti i ke emrat. Ne kërkojmë që ata dy emra ska nevoj as me u votu sepse kanë qenë të rezervuar për ne dhe kur do që të mbahen mbledhjet e Komisioneve dhe Komiteteve këta persona marrin pjesë, se ku ju bani venin ju këtyre të Aleances është çështje e juaja nuk është çështje e jona. Unë kam propozuar një herë me i dhënë zgjidhje kësaj pune dhe zgjidhja në këtë punë kishte me qenë me pas anulë atë vendimin e 2017 dhe me konsistë risht këto Komitete jo obligative në bazë të udhëzimit të ri dhe kështu e kishum zgjidhur problemin. Ne kërkojmë që emrat që i sjellim të dy anëtarëve me u thirr kur të mbahen Komitetet, përndryshe

ata nuk janë legjitim, kjo sështë punë votash por punë udhëzimi dhe është punë propocioni se si ndahen e jo me vota. Faleminderit!

Rrahim Morina:Faleminderit Halil! Ti e din dhe ke qenë prezent që ky Kuvend ju ka rezervuar nga një vend në Komitetet jo obligative, që po thot Hashim Vrenezi. Ju bëjë thirrje që ti bashkangjiti këtyre Komiteteve, ta jepni kontributin si subjekt politik, për shkak se ka nevoj dhe për juve këto Komisione dhe Komitete. Për dy vende unë propozoj që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen tjetër, e kemi dhe një pikë tjetër që nuk kemi material, kerkoj që të na sigurohet material për numrin e të punësuarve në kontratë në vepër në Komunën e Malisheves, qoftë në administrat, në stacion të autobusave apo ku i kanë derguar. Unë do i drejtohem dhe një herë me shkrim drejtoris përkatëse e cila është marrur me këtë çështje. Ju falenderoj për pjesmarrje! Kalofshi mirë!

Mbledhja përfundoi në ora 16:30

Procesmbajtësja:

Albina Zulfaj-Morina



Kryesuesi i Kuvendit

Rrahim Morina


